AKT

PER THEMELIMIN E SH.P.K. "INA"

Une Aleksander Mitrushi,perfundova mareveshjen e meposhteme:

Neni 1

Sh.p.k. do te quhet "INA",ajo ka seline ne Tirane me adrese:Rruga e "Dibres" Nr.106.Ne baze te legjislacionit ne fuqi,ajo mund te hape filiale dhe zyra perfaqesimi te ndryshme brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 2

Sh.p.k. e mesiperme do te kete kapital fillestar te mjaftueshem per fillimin e aktivitetit te saj 100.000 leke.

Neni 3

Personi i mesiperm qe tani e tutje do te quhet ortak i vetem,per te realizuar qellimet e Sh.p.k. mund te perfundoje marreveshje ne emer te saj me cfardo lloj subjekti tjeter te njohur nga ligji si dhe te behet pjesmarrese ne to.

Neni 4

Sh.p.k."INA"ne kuadrin e veprimtarise se lejuar nga statuti do te orientohet kryesisht ne prezantimin dhe zbatimin per vete ose per te tretet te veprave ndertimore,civile,industriale,turistike,bujqesore,rrugore,hekurudhore,hidraulike,restaurimi dhe ne pergjithesi te gjithe llojet e konstruksioneve te inxhinierise civile ne Shqiperi dhe jashte shtetit,drejtimi dhe administrimi i pasurive te patundeshme,dhe per llogari te te treteve,blerje e trojeve per te perdorur per ndertime per qytete dhe fshatra e per te shitur keto ndertime edhe si pjese te vecanta,tregetimi ne pergjithesi i pasurive te

patundeshme,mirembajtja e cdo lloj vepre ose pasurie te patundeshme,ne sektoret me efektivitet te pershkruara me siper,cdo lloj tregetije e njohur nga legjislacioni shqiptar.

Prodhimi i materialeve te ndryshme te ndertimit etj.

Neni 5

Administrator i vetem i Sh.p.k. emerohet me akt-themelimi z.Aleksander Mitrushi.

Neni 6

Kjo Akt-marrveshje eshte nenshkruar ne kater kopje duke patur te gjitha fuqi te barabarte ligjore.

Themeluesi
ALEKSANDER MITRUSHI

Tirane,me 25.10.1995

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 3909.rep
Nr. 1150.kol

V E R T E T I M

Sot me daten 25.10.1995 u paraqit ne zyren e noterise Z.Aleksander Mitrushi,madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar,per identitetin e te cilit u sigurova nga letornjoftimi i tij personal,i cili me deklaroi sa me siper eshte nje akt-themelimi i hartuar jashte kesaj zyre me vullnetin e lire dhe eshte nenshkruar rregullisht dhe une noterja e vertetoje ate sipas ligjit.

N O T E R
Fatmara

DTRRB IRANE

# S T A T U T I

## SHOQERISE NDERTUESE PRIVATE "I N A" sh.p.k.

Ne baze te ligjit Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" ne Tirane sot me daten _____________ shtetasi Aleksander Mitrushi i biri i Thomait, i datlindjes 3.02. 1952, banues ne Tirane,rruga e Dibres, Nr.106 vendosa te krijoje shoqerine ndertuese private "I N A"sh.p.k. Tirane.

## K R E U I

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### N e n i 1

Shoqeria ndertuese private "I N A" sh.p.k. eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuar me ligj.

### N e n i 2

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj private ne baze te okonomise se tregut te lire.

### N e n i 3

Themeluesi i shoqerise ne kete sipermarrje ka ka derdhur kapitalin e tij, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private ndertuese, si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e vlerave.

### N ENI 4

Shoqeria"I N A"sh.p.k. eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e shoqerise ne gjykaten e rrethit Tirane dhe paisjes me lejen e ushtrimit te profesionit nga zyra e tatimeve te rajonit perkates.

N e n i 5

Emertimi i shoqerise do te jete:

Shoqeria ndertuese private "I N A" sh.p.k. Tirane.

N e n i 6

Selia e shoqerise do te jete ne adresen Rruga e "Dibres" Nr.106 Tirane.

Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

N e n i 7

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete per kategorite e specifikuara te punimeve:

Kat.1- Punime dheu, murature, betoni, beton arme e zakoneshme,punime shembjesh.

Kat.2- Ndertime civile,industriale, turistike, bujqesore, etj e kompletimin me instalimet e nevojshme per to.

Kat.3- Punime restaurimi etj

Kat.4- Vepra beton arme te veçanta

Kat.7- Ndertime vepra arti rrugore e hekurudhore

Kat.8- Punime te shtresave te rrugeve

Kat.9- a,b,c

Kat.11- Diga,galeri,tunele.

Aktivitet privat shitblerje, brenda e jashte vendit me shumice e pakice,eksport-import te londeve te para e ndihmese, te materialeve te ndryshme te ndertimit.

N e n i 8

Aktiviteti privat i shoqerise do te zhvillohet ne nje afat te pacaktuar.

NOTERE TIRANE

# K A P I T A L I   I   S H O Q E R I S E

## N e n i 9

Kapitali themelor i shoqerise "I N A" sh.p.k. perbehet nga kontributi fillestar i themeluesit te shoqerise ne vleften 100.000 leke. Kapitali mund te ritet me zhvillimin e veprimtarise private te shoqerise.

## N e n i 10

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje vlere me te vogel se 100.000 leke e detyron shoqerine te shndrohet ne nje forme tjeter ne rast se ajo nuk merr vendime per rritjen e kapitalit themeltar te pakten deri ne vleren e mesiperme.

## N e n i 11

Kapitali themelor mund te transferohet ne rruge trashegimie, personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, ose ortakeve ne raste se shtohet numri i tyre.
Transferimet e kapitalit duhet te vertetohen me akt noterial

# D R E J T I M I   A D M I N I S T R A T I V

## N e n i 12

Shoqeria "I N A"sh.p.k. Tirane do te kete si administrator z. Aleksander Mitrushi. Themeluesi i shoqerise ka ne kompetence te caktoje si administrator edhe persona te tjere te cilet nuk e kane cilesine e ortakut.

## N e n i 13

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e veprimtarise se shoqerise. Ai mund te kryej te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

## N e n i 14

Ne mardhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Ne rastet kur administratori eshte i emeruar nga themeluesi i shoqerise, kryen te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise, me perjashtim te atyre qe jane ne kompetencen e themeluesit te shoqerise.

## N e n i 15

Ortaku i vetem themelues ka ne kompetence:

- Te miratoje programin e shoqerise, te hartoje raportin e administrimit,inventaret, llogarite vjetore te cilat hartohen brenda nje afati 6-mujor duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.
- Vendos per shperberjen e shoqerise
- Vendos per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve
- Rregullon mardheniet e punesimit dhe te shperblimit brenda shoqerise.
- Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shteterore , personave juridik e fizik vendas e te huaj.

## M A R D H E N I E T   F I N A N C I A R E

## N e n i 16

Shoqeria "T N A"sh.p.k. mund te lidh kontrata me sektoret shteteror,drejtperdrejt ne tregun e lire,si dhe me persona juridike e fizike vendas e te huaj,sipas legjislacionit ne fuqi per eksport-importet.

## N e n i 17

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga administratori Aleksander Mitrushi ose persona te tjere te autorizuar prej tij.

## N e n i 18

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyru-

eshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

N e n i 19

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, detyrimet ndaj shtetit sigurimeve shoqerore etj. Shoqeria ka te drejte te çele llogari likuiduese prane bankave te vendit dhe te kryeje veprimet e likuidimit nepermjet tyre. Gjithashtu ka te drejte te vetfinancohet ne leke ose ne valute te huaj.

N e n i 20 .

Shkembimin e monedhes shqiptare ne monedhe te huaj dhe anasjelltas mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shqiperise ose ne tregun e lire privat te valutes.

N e n i 21

Per pasqyrimin e aktivitetit ndertues dhe ekonomiko-financiar, administratori eshte i detyruar te mbaje dokumentacion te rregullt financiar dhe regjistrat perkates, sipas ligjit te veçante.

N e n i 22

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron ne muajin Dhjetor te çdo viti Administratori eshte i detyruar te paraqese bilancin periodik, bilance vjetor se bashku me deklaraten e fitimeve dhe humbjeve dhe ti depozitoj ato ne organin financiar te juridiksionit perkates ku ushtron aktivitetin shoqeria.

M A R R D H E N I E T E P U N E S I M I T

N e n i 23

Themeluesi i shoqerise vendos per shtimin ose paksimin e numrit te ortakeve dhe personave qe do te punesohen ne veprimtarine e shoqerise "T N A2 s h .p.k. Tirane

## N e n i 24

Mardheniet e punes dhe punesimit rregullohen ne baze te kontrates se punes qe lidhet ndermjet administratorit dhe te interesuarit. Marrja ne pune behet ne regjistrimin e punonjesve ne librin e punes te shoqerise si dhe duke njoftuar organet e punes te juridiksionit ku e ushtron aktivitetin shoqeria.

## N e n i 25

Ortaku i vetem ka te drejte te kerkoje respektimin e disiplines ne pune nga punonjesit e shoqerise, te cilet mbajne pergjegjesi per thyerjen e saj sipas ligjeve ne fuqi.

## N e n i 26

Ndaj personave qe demtojne pronen e shoqerise zbatohen masa ndeshkimore, te cilat percaktohen nga themeluesi i shoqerise dhe ne mungese te tyre zbatohen dispozitat e mardhenieve te punes.

## N e n i 27

Kontrata e punes mund te lidhet me ose pa afat te caktuar, nga ortaku i vetem themelues ose ortakot e tjere ne rast se shtohet numri i tyre dhe ne mungese te parashikimeve ne kontrate, sipas ligjeve te shteti shqiptar.

## N e n i 28

Punonjesit gezojne lejen vjetore dhe leje plotesuese sipas kritereve te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese te tyre sipas ligjit"Mbi mardheniet e punes" ne Republiken e Shqiperise.

## N e n i 29

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortaku themelues z. Aleksander Mitrushi. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljeve disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit.

N e n i 30

Punonjesi qe largohet ose transferohet ne nje pune tjeter duhet te beje dorzimet e detyres ne baze te nje akti me shkrim, pasi te kete likuiduar detyrimet materiale e monetare. Akti i mesiperm mbahet nga administratori i shoqerise.

E L E M E N T E  T E  T J E R A

N e n i 31

Shoqeria mund te marr truall me qira ose te bleje truall per ndertim, si dhe objekte te ndertuara, sipas nje kontrate te vecante.

N e n i 32

Dhenia e truallit, e objekteve dhe vlefta perkatese e tyre percaktohen nga organi financiar ne juridiksionin e te cilit ndodhet trualli ose objekti

K R E U III

B I L A N C I  D H E  T E  A R D H U R A T

N e n i 33

Te ardhurat nga veprimtaria private do te sigurohen sipas çmimeve qe i cakton vet shoqeria. Çmimet dhe tarifat do te caktohen sipas kerkeses dhe ofertes.

N e n i 34

Te ardhurat neto pas shlyerjes se detyrimeve fiskale sigurimeve shoqerore etj, kalojne ne pronesi te ortakut themelues ose te ortakeve ne se ka te tille dhe ndahen sipas kontributit te secilit.

N e n i 35

Shperblimi ne veprimtarine e shoqerise "I N A" sh.p.k. caktohet sipas kontrates se punes.

Ndryshimi ne page vendoset nga themeluesi i shoqerise ose nga ortaket ne rast se shtohet numri i tyre.

NOTER TIRANE

N e n i 36

Shoqeria perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre fillestar ne kapitalin baze.

N e n i 37

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur ose shtuar shumat respektive te humbjeve apo fitimeve mbartur nga vitet e meparshem.

N e n i 38

Kur pushon aktiviteti i shoqerise kapitali i mbetur mbasi shlyhen te gjitha detyrimet i mbetet ortakut themelues.

SHPERBERJA E SHOQERISE

N e n i 39

Ne rast se kapitalet e shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat financiare rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku themelues vendos brenda 4 muajve nga data e konstatimit mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise dhe mund te kerkoje ne gjykate prishjen e saj.

N e n i 40

Mosmarveshjet e shoqerise ne mardhenie me persona juridik e fizik vendas e te huaj zgjidhen ne mirkuptim, ne te kundert kur kjo nuk arihet zgjidhet nga gjykata e rrethit Tirane.

DISPOZITA TE FUNDIT

N e n i 41

Per sa eshte shprehur ne kete statut i referohet ligjit Nr. 7512 date 10.08.1991, ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe çdo akti tjeter te legjislacionit shqiptar.

N e n i 42

Statuti perpilohet ne disa kopje per tiu dorezuar organeve kompetente Nje kopje e tij mbetet si pjesa e dokumentacionit te formimit te shoqerise ndertuese private "I N A" sh.p.k. Tirane.

U nenshkrua ne Tirane sot me daten 25.12-94

THEMELUESI
ALEKSANDER MITRUSHI